

MNN QENDRORE



MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

29 tetor 2025

NJË SHIKIM I SHPEJTË MNN




Përditësimi i Javës Globale të Lutjes

Rajoni i Euroazisë (India Lindore)



“Ishte një përvojë e mrekullueshme, ndërsa luteshim së bashku për rajone të ndryshme të botës. U takuam edhe në internet. Gjatë kësaj kohe lutjeje përjetuam unitetin. Ndjemë mbushjen e Frymës së Shenjtë dhe gëzimin ndërsa luteshim së bashku. U bëmë pjesë e Kishës globale ndërsa ndiqnim kërkesat e lutjes.”

Mesoamerika (Meksika Perëndimore)



“Gjatë Javës Globale të Lutjes, përqipemi të mobilizojmë kishat në gjithë distriktin tonë me qëllim përfshirjen e të rriturve, të rinjve dhe fëmijëve. Është një kohë ndërmjetësimi për Kishën e Nazaretasit. Ne bashkëpunuam gjithashtu me ekipin e DNN të distriktit, duke u kërkuar presidentëve të mbështesin këtë thirrje për lutje për misionet. Mësuesit e shkollës të së Dieles shpërndanë materialin përkatës për çdo fëmijë në mënyrë që ata të mund të merrnin pjesë aktive gjatë javës në një kohë lutjeje të bashkuar.”

Amerika e Jugut (Kolumbia dhe Paraguai)



“Ne u mblodhëm për t'i kërkuar Frymës së Shenjtë të na udhëheqë në ndërmjetësimin tonë. Ne u lutëm jo vetëm për nevojat e Kolumbisë, por edhe për rajonet dhe kombet tona, për zgjerimin e Mbretërisë dhe për rizgjim të vërtetë. Gjithashtu ne ngritëm zërat tanë në mirënjohje për të gjitha ato që Perëndia ka bërë tashmë.” “Edhe Fëmijët u lutën për misionet.”

SHBA dhe Kanada



“Ne u ndamë në gjashtë grupe, secili grup u përqendrua në një rajon specifik, duke u lutur për misionarët dhe duke u shkruar atyre mesazhe inkurajimi. Kjo ndihmoi për të rritur ndjenjën e lidhjes me kishën tonë globale.” “Fëmijët komentuan se zbuluan se Perëndia mund t'u përgjigjet lutjeve në mbarë botën dhe thanë se një ditë do të donin të takonin njerëzit për të cilët u lutën.”

Rajonet: Afrika, Azi-Paqësori, Euroazia, Mesoamerika, Amerika e Jugut, SHBA-Kanada



Imagjino Ndikimin e Lutjes!

Kur...



2,781,500 Anëtarë...po
luten!



23,579 Kisha të
Organizuar Plotësisht;
7,006 Kisha të
Paorganizuar...po luten!



10,803 Shërbëtorë të
Liçensuar në Distrikte dhe
20,885 Shërbëtorë të
Shuguruar në 473
Distrikte dhe
në 29 Zona Pioniere...po
luten!

Kur...ju luteni!

Kur ju luteni, ju po merrni pjesë në mënyrë aktive...duke zgjedhur t'i bashkoheni Perëndisë në atë që Ai tashmë po bën. Lutja mund të bëhet vetëm ose me të tjerët. Lutja mund të jetë e heshtur, një pëshpëritje, një britmë, një thirrje, një shpërthim emocionesh në çdo gjuhë. Lutja mund të flitet, të këndohet, të shkruhet, apo edhe të vizatohet. Lutja është një bashkëveprim intim dhe relacional me Atë që na krijoi dhe na formoi, i Madhërishti Unë Jam-i, Perëndia Ati ynë. Ndërsa shikojmë botën tonë të thyer dhe të plagosur, kemi më shumë pyetje sesa përgjigje për të përmbushur nevojat e epokës në të cilën jetojmë. Megjithatë, ne e dimë se përgjigjja gjendet tek Jezusi!

Në vitin 2026, Misionet Ndërkombëtare Nazaretase do të festojnë 30-vjetorin e thirrjes që I bën Kishës së Nazaretasit për të marrë pjesë në Javën Globale të Lutjes (JGL). Çdo vit, javën që përfshin të Premten e parë të Marsit (e caktuar si Dita Botërore e Lutjes), Nazaretasit në mbarë botën udhëhiqen përmes temave të lutjeve dhe lavdërimit nga secili prej gjashtë rajoneve të botës. Shumë prej tyre vazhdojnë të lutën gjatë gjithë vitit për kërkesat e theksuara të JGL 2025. Janë përgatitur materiale për të rritur dhe fëmijë për të inkurajuar pjesëmarrjen e plotë në Javën Globale të Lutjes 2026. Këto materiale do të jenë të disponueshme në Vitin e Ri, duke shpresuar për më shumë se 30 gjuhë.

Shënoni në kalendarët tuaj, vendosni një alarm, tregojini miqve tuaj... është një javë kur Nazaretasit në të gjithë botën do të bashkohen në çdo kontinent, në çdo zonë kohore, për t'u lutur, lavdëruar dhe për të marrë pjesë në atë që Perëndia ynë ka bërë, po bën dhe do të bëjë. A jeni gati? Mos e humbisni! Lutuni me ne!

Java Globale e Lutjes 2026: 1-7 Mars

A mund të shërbeni?

A po ju thërret Zoti të bashkoheni në misionin e Tij në Rajonin e Afrikës? Për më shumë informacion, [klikoni këtu](#).

NMI Central është i disponueshëm në një arkiv PDF të kuruar. Për të lexuar botimet e mëparshme, [klikoni këtu](#).



KISHA E NAZARENIT
MISIONET NDËRKOMBËTARE
NAZARETASE